



U.S. Embassy in Albania

Consular Section | U.S. Citizen Services

RAPORTI KONSULLOR I LINDJES JASHTË SHBA-së (CRBA)

[PROCESI I APLIKIMIT PËR FËMIJËT NËN MOSHËN 18 VJEÇ TË LINDUR NGA PRINDËR QYTETAR AMERIKAN]

Gusht 2021

Ju lutemi shtypeni (print) këtë listë dhe paraqiteni atë në datën e takimin tuaj. Aplikimi bëhet vetëm duke caktuar një takim në internet. Ju nuk mund të aplikoni për një CRBA pa një takim të planifikuar për secilin aplikant (fëmijë). Në rast se keni emergjencë për të udhëtuar, ju lutemi na shkruani ose na merrni në telefon. Nëse aplikoni për dy ose më shumë fëmijë në të njëjtën ditë ju lutemi na shkruani.

Ju lutemi vendosni një "X" për dokumentat që ju do të sillni ditën e intervistës sipas kutisë përkatëse në anë të dokumentit të kërkuar në listë. Shumica e dokumentacionit të kërkuar duhet të jetë original dhe shoqëruar me fotokopjet përkatëse, përveç rasteve kur shkruhet ndryshe. Dokumentacioni duhet vendosur në të njëjtën mënyrë si në listë me origjinalin në krye të kopjeve. Nëse aplikantët paraqiten 30 minuta me vonesë nga orari i takimit, takimi i tyre do të anulohet dhe ata do të duhet të caktojnë një takim të ri.

Pasi t'i keni grumbulluar të gjitha dokumentat e kërkuara më poshtë, ju lutemi caktoni një takim në internet sipas "Kalendarit Elektronik" që gjendet në faqen e internetit: <http://go.usa.gov/KtRT>, dhe zgjidhni mundësinë e dytë (Report the birth abroad...)

Ju lutemi paraqituni 15 minuta më herët për të evituar vonesat e hyrjes. Sapo të kaloni kontrollin e sigurisë paraqituni në Sportelin Nr. 2 menjëherë. Staf i ynë do të grumbullojë dokumentacionin dhe do të hedhë të dhënat në sistem. Ky proces mund të zgjasë në varësi të volumit të dokumentacionit që paraqitet. Pasi të grumbullohet dokumentacioni, do t'ju kërkohet të kryeni pagesën dhe do të prisni për intervistë me zyrtarin konsullor. Nëse paraqiteni pa plotësuar formularin e aplikimit si dhe dokumentacionin e kërkuar më poshtë, takimi juaj do të anulohet dhe do t'ju kërkohet të largoheni që të caktoni një takim të ri. Dokumentacioni original do t'ju kthehet në përfundim të procesit.

Vinie re se, për arsye sigurie nuk do të lejoheni të hyni në konsullatë nëse keni me vete pajisje elektronike si tablet apo laptop; ndërsa celularët mund t'i lini në kutitë e posaçme në portën hyrëse.

Lista e dokumentacionit vijon në faqet pasardhëse...

LISTA E DOKUMENTACIONIT

APLIKIMI PËR CRBA

Ju lutemi paraqesni:

Këtë Listë të Nënshkruar.

Sigurohuni që të kuptoni nëse ju mund t'i transmetoni nënshtetësinë Amerikane fëmijës tuaj të lindur jashtë SHBA-së.

Vizitoni travel.state.gov (<https://go.usa.gov/xQKPx>- në Anglisht) për të mësuar më shumë.

Formulari DS-2029:

(<https://eforms.state.gov/Forms/ds2029.PDF> - PDF 104 KB - Anglisht)

Formulari është krijuar që të plotësohet në internet përpara se t'a stamponi atë. Formulari i plotësuar me shkrim dore mund të pranohet, por duhet të siguroheni që të jetë i qartë dhe pa korigjime, në të kundërt nuk do të pranohet. **Formulari NUK duhet firmosur. Nëse formularin nuk është i plotësuar nuk do të pranojmë aplikimin tuaj.**

E rëndësishme:

- Emri i aplikantit (fëmijës) duhet plotësuar saktësisht ashtu si paraqitet në certifikatën e lindjes të lëshuar nga autoriteti i gjendjes civile të qytetit ku është regjistruar. Për informacion se si të merrni një certifikatë lindje, lexoni më poshtë.
- Në faqen e dytë të formularit, do t'ju kërkohet të listoni datat kur prindi qytetar Amerikan ka qendruar në Shtetet e Bashkuara. Ju lutemi sigurohuni që të shkruani të gjitha datat e hyrjeve dhe të daljeve nga Shtetet e Bashkuara. Për shëmbull: nëse ju keni udhëtuar për në Shqipëri për një periudhë dy-javore dhe nuk i mbani mend datat saktë, ju mund të shkruani datat afërsisht që të llogaritet dy-javëshi që keni qendruar jashtë SHBA, si në shëmbullin e ilustruar më poshtë:

24. Precise Periods of Time in United States
(if additional space is needed, please use the Section D Continuation Sheet)

Place (City, State)	Date Time spent in USA (month-day-year)	
	From	To
Bronx, NY	05/08/2000	12/24/2005
Bronx, NY	01/08/2006	08/01/2007
Bronx, NY	09/01/2007	and so on...
	From	To

Time spent abroad

Shënim: Në rast se prindi Amerikan që transmeton qytetarinë Amerikane fëmijës nuk ndodhet në Shqipëri, pra nuk do të jetë i pranishëm gjatë intervistës, atëhere ai ose ajo duhet të plotësojë dhe të përfshijë në këtë aplikim formularin DS-5507. Formulari duhet plotësuar dhe noterizuar nga një noter në SHBA, ose nga një zyrtar konsullor i Ambasadës së SHBA të shtetit ku ndodhet prindi transmetues.

Formulari DS-5507:

(<https://eforms.state.gov/Forms/ds5507.PDF> - PDF 112 KB - Anglisht)

Formulari është krijuar që të plotësohet në internet përpara se t'a stamponi atë. Formulari i plotësuar me shkrim dore mund të pranohet, por duhet të siguroheni që të jetë i qartë dhe pa korigjime, në të kundërt nuk do të pranohet.

Ky formular duhet plotësuar dhe paraqitur në rastet kur prindi qytetar Amerikan transmetues i qytetarisë Amerikane nuk ndodhet në Shqipëri, pra nuk do të jetë i pranishëm gjatë intervistës. Gjithsesi, zyrtari konsullor mund të përcaktojë gjatë intervistës që ky formular duhet plotësuar ose jo.

Nëse ky formular kërkohet dhe prindi qytetar Amerikan do të jetë i pranishëm në intervistë, formulari **nuk duhet firmosur**. Nëse prindi Amerikan nuk ndodhet gjatë intervistimit formulari duhet plotësuar dhe noterizuar nga një noter në SHBA, ose nga një zyrtar konsullor i Ambasadës së SHBA të shtetit ku ndodhet prindi transmetues.

Certifikata e Lindjes së Fëmijës:

Nëse fëmija ka lindur në Shqipëri, spitali do të lëshojë një vërtetim të titulluar "Certifikatë Asistencë Lindje" të cilën duhet t'a dorëzoni në zyrën e gjendjes civile të vend-banimit tuaj apo të bashkëshortit/es tuaj. Nëpunësi i gjendjes civile do të mbajë aktin e lindjes bazuar në vërtetimin e spitalit dhe do të lëshojë një certifikatë lindje. Vini re se certifikata duhet të titullohet "CERTIFIKATË LINDJE" dhe jo personale. Sillni originalin e certifikatës së lindjes së fëmijës të lëshuar nga autoritetet përkatëse Shqiptare dhe dy fotokopje të saj. Certifikata duhet të jetë e përkthyer dhe noterizuar nëse nuk është në Anglisht ose paraqesni formatin shumë gjuhësh ku përfshihet edhe ajo Angleze. Autoriteti lëshues zyrtar i Shqipërisë është Zyra e Gjendjes Civile të bashkisë apo komunës ku keni regjistruar lindjen e fëmijës. Të dhënat e lindjes spitalore apo fetare nuk pranohen.

Fotografi të Rritjes së Fëmijës:

Kjo kërkohet vetëm kur fëmija nuk është më foshnje (psh: 12 muajsh e sipër). Fotografitë e rritjes duhet të jenë sa më pranë momentit të lindjes deri në kohën e tanishme (psh: çdo 3-6 muaj).

Dëshmi të Nënshetësisë Amerikane të Prindit (Prindërve):

Të gjitha dokumentet origjinale të paraqitura si provë të qytetarisë Amerikane do t'ju kthehen. Ju lutemi paraqesni originalin dhe një fotokopje të njërit prej dokumentave të mëposhtëm:

- Certifikatën e Lindjes të Certifikuar nga Autoriteti Lëshues së Qarkut ose Shtetit në SHBA;
- Raportin Konsullor të Lindjes Jashtë Vendit ose Vërtetim Lindje;
- Certifikatë Natyralizimi;
- Certifikatë Shtetësie;
- Pasaportën e Vlefshme Amerikane.

Për më shumë informacion lexoni në lidhje me dëshmi të nënshetësisë Amerikane, mund të lexoni këtu <https://go.usa.gov/xngnB> (në Anglisht).

Shënim: Në rast se prindi Amerikan që transmeton qytetarinë Amerikane fëmijës nuk ndodhet në Shqipëri, pra nuk do të jetë i pranishëm gjatë intervistës, atëherë ai ose ajo mund të paraqesë kopjet e origjinalit të kërkuar më sipër të noterizuara nga një noter në SHBA, ose nga një zyrtar konsullor i Ambasadës së SHBA të shtetit ku ndodhet prindi transmetues.

Pasaporta/Dokumenti i Identifikimit të Prindit Qytetar Amerikan:

Prindi qytetar Amerikan duhet të paraqesë pasaportën Amerikane aktuale të tij/saj dhe dy fotokopje të faqes biografike. Prindi qytetar Amerikan që transmeton qytetarinë Amerikane fëmijës duhet të përfshijë gjithashtu të gjitha pasaportat (nëse i ka) që ka përdorur më parë.

Shënim: Në rast se prindi Amerikan që transmeton qytetarinë Amerikane fëmijës nuk ndodhet në Shqipëri, pra nuk do të jetë i pranishëm gjatë intervistës, atëherë ai ose ajo mund të paraqesë kopjet e origjinalit të kërkuar më sipër të noterizuara nga një noter në SHBA, ose nga një zyrtar konsullor i Ambasadës së SHBA të shtetit ku ndodhet prindi transmetues.

Pasaporta/Dokumenti i Identifikimit të Prindit Jo-Qytetar Amerikan:

Prindi jo-qytetar Amerikan duhet të sjellë pasaportën ose kartën kambëtare të identitetit të tij/saj dhe dy fotokopje të faqes identifikuese.

Certifikata e Martesës së Prindërve, nëse jeni të martuar:

Ju lutemi sillni certifikatën origjinale të martesës dhe një fotokopje. Certifikata duhet të jetë e përkthyer dhe noterizuar nëse nuk është në Anglisht. Nëse martesa ka ndodhur në Shqipëri mund të kërkonte t'iu lëshohet një certifikatë në formatin shumë gjuhësh ku përfshihet edhe ajo Angleze.

Certifikatë Divorci, Vendim Gjykatë apo Certifikatë Vdekje, nëse ka:

Prindërit duhet të tregojnë përfundimin e të gjitha martesave të mëparshme me vendim gjykatë ose me certifikim zyrtar. Ju lutemi sillni origjinalet e certifikuara nga autoriteti lëshues, të përkthyer në Anglisht dhe të noterizuara nëse nuk janë në gjuhën Angleze. Sillni një fotokopje për çdo dokument.

Dëshmi të Pranisë Fizike dhe Banimit në Shtetet e Bashkuara:

Kjo është pika më e rëndësishme e procesit.

Prindi qytetar Amerikan duhet të paraqesë dëshmi të pranisë fizike në Shtetet e Bashkuara përpara lindjes së fëmijës sipas ligjit në fuqi. Ju lutemi mundohuni të sillni origjinalet. Se si provoni praninë tuaj fizike në SHBA varet shumë nga situata juaj. Nuk ka një përgjigje specifike në lidhje me dokumentacionin/provat që duhet të paraqesni. Disa shembuj të pranueshëm përfshijnë:

- Dëshmi që keni qenë në shkollë në SHBA (Diploma apo lista e notave);
- Deklaratë nga Zyra e Shërbimeve Shoqërore, që mund ta merrni në internet në ssa.gov (<https://go.usa.gov/xngnk>), ose prova që keni paguar deklaruar taksat (të cilat mund t'i gjeni nëpërmjet internetit irs.gov (<https://go.usa.gov/xngnk>));
- Të dhëna nga punësimi, ushtria, apo spitalet;
- Pasaportat e vjetra me datat e hyrjeve/daljeve nga SHBA (ose mund të kërkonte certifikim të hyrjeve daljeve nga zyra e kufirit në SHBA sipas udhëzimit të dhënë në faqen e tyre të internetit <https://go.usa.gov/xngn9>);
- Etj.

Sa më shumë dëshmi të sillni, aq më e lehtë do të jetë për zyrtarin konsullor të miratojë aplikimin.

Shënim: Në rast se prindi Amerikan që transmeton qytetarinë Amerikane fëmijës nuk ndodhet në Shqipëri, prindi tjetër mund të paraqesë këto dëshmi.

Të Dhëna Para-Lindjes apo Dëshmi të Tjera të Shtatzanisë së Mamasë:

Sillni dëshmi gjatë kohës kur mamaja ka qenë shtatzanë (letra nga doktori, fatura, eko, receta të ndryshme). Sillni origjinalet.

Dëshmi të Marrëdhënieve të Çiftit Përpara Konceptimit të Fëmijës:

Barra për të pasur një pretendim për nënshtetësinë Amerikane, duke përfshirë edhe lidhjen e gjakut me fëmijën, bie mbi prindin qytetar Amerikan që transmeton nënshtetësinë. Fotografitë përpara kohës së konceptimit të fëmijës, letra dhe korrespondenca të tjera mund të ndihmojnë në krijimin marrëdhënies së çiftit përpara konceptim të fëmijës.

Në rastet kur ka dyshime në lidhjen e gjakut midis prindit transmetues dhe fëmijës, zyrtari konsullor mund të kërkojë testimin gjenetik (ADN) midis prindit dhe fëmijës. ADN-ja është një mjet i dobishëm për të verifikuar një marrëdhënie të deklaruar biologjike, kur nuk ka formë tjetër të provave të besueshme në lidhje me një CRBA ose aplikim për pasaportë. **Testimi ADN-së bëhet vetëm me rekomandim të zyrtarit konsullor dhe nëpërmjet laboratorëve të licensuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Çdo test AND-je tjetër nuk do të pranohet.**

Tarifa e Aplikimit e Parimbursueshme:

Tarifa e aplikimit të CRBA është **100** Dollarë. Paga kryhet te arkëtari i Zyrës Konsullor, dhe mund të bëhet me para në dorë (Dollarë ose Lekë) ose me kartë krediti (Visa, Master Card, American Express, Diners Club, dhe Discover). Nëse paguani me para në dorë, mundohuni që paratë të mos kenë njolla boje.

APLIKIMI PËR PASAPORTË

SHUMË PRINDËR DËSHIROJNË TË APLIKOJNË NË TË NJËJTËN KOHË PËR PASAPORTË MENJËHERË PAS CRBA. NËSE NUK APLIKONI PËR PASAPORTË NJËKOHËSISHT, JU (TË DY PRINDËRIT) SË BASHKU ME FËMIJËN DO T'JU DUHET TË PARAQITENI NJË DATË TJETËR PËR INTERVISTE. Prindërit e interesuar për të përfutur nga ky rast i përshtatshëm për të aplikuar për të dyja dokumentat duhet të vijnë të përgatitur me formularët e mëposhtëm përveç atyre që kërkohen më lart:

Formulari DS-11: Aplikim për një Pasaportë Amerikane:

Ju mund të plotësoni versionin në internet (online) të aplikimit (<https://pptform.state.gov/>) dhe pastaj ta shtypni (print) ose të shtypni një formular bosh në versionin PDF (<https://eforms.state.gov/Forms/ds11.PDF> - 100 KB) dhe pastaj ta plotësoni me shkrim dore (boje të zezë ose blu).

- Ju lutemi mos e firmosni formularin e aplikimit deri në momentin që do t'ju kërkohet për ta firmosur;
- Sigurohuni që ta plotësoni formularin pa gabime ose korigjime;
- Për shkak se fëmija juaj nuk ka një numër sigurimesh shoqërore, shkruani 000-00-0000 në fushën përkatëse, dhe paraqesni një deklaratë të firmosur (një shëmbull gjendet këtu: <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/no-ssn-declaration.pdf>);
- Në pike 8 të formularit vendosni adresën e plotë në Shqipëri "si adresë poste", edhe nëse fëmija juaj nuk do të qendrojë në këtë adresë për një kohë të gjatë. Ne nuk do t'ju dërgojmë postë në këtë adresë.

Miratimi i Prindërve:

Për aplikantët e pasaportave nën moshën 16 vjeç, të dy prindërit duhet të japin miratimin e tyre për lëshimin e pasaportës. Nëse kjo nuk është e mundur, ju lutemi lexoni në faqen e internetit (<https://go.usa.gov/xngnU>) dhe ndiqni udhëzimet që i përkasin rrethanës tuaj.

Shënim: Nëse ju përdorni formularin DS-3053 (<https://eforms.state.gov/Forms/ds3053.pdf> - PDF 52 KB) për të miratuar lëshimin e një pasaporte për fëmijën tuaj kur ju nuk ndodheni në Shqipëri, ju duhet të firmosni dhe noterizoni këtë formular nga një noter i licensuar në SHBA, ose nga një zyrtar konsullor Amerikan nëse ndodheni jashtë SHBA-së. Mos harroni të përfshini edhe një fotokopje të kartës së identitetit që keni përdorur gjatë noterizimit të këtij formulari.

1 Fotografi për Fëmijën:

Ju duhet edhe një fotografi për pasaportë në formatin Amerikan (5cm x 5 cm katrore). Lexoni udhëzimet këtu (<https://go.usa.gov/xngnn>) për një shembull fotografie për pasaportë.

Tarifa e Aplikimit e Parimbursueshme:

Tarifat aktuale për shërbimet e pasaportës janë të disponueshme (<https://travel.state.gov/content/travel/en/passports/how-apply/fees.html>)

Pagesa kryhet te arkëtari i Seksionit Konsullor, dhe mund të bëhet me para në dorë (Dollarë ose Lekë) ose me kartë krediti (Visa, Master Card, American Express, Diners Club, dhe Discover). Nëse paguani me para në dorë, mundohuni që paratë të mos kenë njolla boje, ndryshe nuk do të pranohen.

APLIKIMI PËR NUMËR TË SIGURIMEVE SHOQËRORE (SSN)

Është një ide e mirë për të marrë këtë numër SSN kur fëmija lind. Marrja e kartës me një numër sigurimesh shoqërore për të porsalindurin tuaj është vullnetare dhe falas. Ky numër ju duhet që të përfshni fëmijën tuaj si pjestar të familjes kur deklaroni taksat. Gjithashtu fëmijës i nevojitet ky numër nëse keni ndërmend të: (1) Hapni një llogari bankare për fëmijën; (2) Blini bono thesari për fëmijën; (3) Të pajisni fëmijën me mbulim mjeksor; ose (4) Të aplikoni për shërbime shtetërore për fëmijën. Administrata Amerikane e Sigurimeve Shoqërore do t'ju dërgojë me postë kartën me numrin e sigurimeve shoqërore në adresën që do të vendosni në formularin e aplikimit.

SHËNIM: Që prej datës 10 tetor 2017, zyra jonë nuk do të pranojë aplikime për numrin SSN.

Nëse jetoni jashtë SHBA-së dhe dëshironi të aplikoni për një numër SSN për fëmijën tuaj, ju lutemi kontaktoni Zyrën Rajonale të Përfimtimit Federale (RFBO) në Romë të Italisë sipas udhëzimeve në faqen e tyre të internetit <https://it.usembassy.gov/u-s-citizen-services/fbu/fbu-rome-inquiry-form/>.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ne jemi të gatshëm për t'ju ndihmuar, por pengesa më e madhe në një përfundimin të shpejtë të procesit të aplikimit është marrja e të gjitha dokumenteve të nevojshme. Në qoftë se ju **nuk paraqesni** dokumentacionin e kërkuar së bashku me fotokopjet sipas kësaj liste, ne do të anulohet procesin e aplikimit dhe do t'ju duhet të caktoni një takim tjetër. Në çdo aplikim për CRBA detajet janë shumë të rëndësishme dhe gjykojnë sipas secilit rast specifik. Mund të ndodhë që gjatë intervistimit zyrtari konsullor të kërkojë dokumentacion apo dëshmi të tjera në lidhje me aplikimin tuaj. Në rast se kjo ndodh, sipas rregullores ju do të keni 90 ditë kohë për të paraqitur dokumentacionin e kërkuar, në të kundërt rasti juaj do të mohohet për prova të pamjaftueshme. Vini re pagesat e aplikimeve nuk rimbursohen.

Ju urojmë fat,

Spektori për Shërbimet e Qytetarëve Amerikanë
Zyra Konsullore | Ambasada e SHBA-së | Tiranë